



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE**

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E PROJEKTEVE**

Tiranë, 10 Prill 2025

Hapja e mbledhjes

Mbledhja u hap nga *Znj. Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV* e cila përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre. Ajo u shpreh se ky takim është një vazhdim i takimeve të tjera të mbajtura gjatë kësaj jave në lidhje me treguesit e performancës së bashkive të zhvilluar vitin e kaluar. Ajo theksoi se qëllimi i këtyre takimeve konsultuese është përmirësimi i treguesve në bazë të problematikave të hasura me ushtrimin e realizuar, për të konsoliduar procesin duke e bërë më gjithpërfshirës.

Znj. Caca, vijoi me prezantimin e gjetjeve nga raporti i SMP 2023:

- Të dhënat janë siguruar nëpërmjet databazës së ngritur nga projekti “Bashkitë për në Evropë” dhe janë raportuar nga bashkitë nëpërmjet Njësive të Integritimit Evropian;
- 53 bashki kanë përfituar projekte dhe vetëm 8 nuk kanë arritur të kenë asnjë projekt;
- Bashkitë që kanë realizuar më shumë projekte janë Berati (20 projekte), Gjirokastra (17) dhe Përmeti (13);
- Shuma totale e fondeve nga donatorët arrin në vlerën 46.174.419 €, prej te cilave 54% e tyre mbulohet nga Bashkimi Evropian;
- Bashkitë e vogla rezultojnë me nivelin më të lartë të fondeve për frymë prej 65 € për banorë, ndërsa bashkia Tiranë rezulton me vlerën më të ulët prej 6 € për banorë;
- Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi përfaqëson 24,2% të projekteve me vlerë 11 milion euro;
- Bujqësia, Mjedisi dhe Pyjet zënë 23,5%, duke reflektuar përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e bujqësisë;
- Shëndetësia dhe Shërbimi Social ka numrin më të madh të projekteve, por me fonde të pakta;
- Arsimi, Digjitalizimi dhe Siguria Publike rezultojnë me mbështetjen më të kufizuar, si në vlerë fondesh ashtu edhe në numër projektesh.

Komente

Znj. Voltana Ademi, Ekspert, Smart Processes iu referua metodologjisë së përdorur, nëse janë përfshirë projektet që janë aplikuar, administruar dhe shpenzuar nga bashkia.

Znj. Caca vijoi duke sqaruar se nuk bëhet fjalë për një vit konkret, pasi të dhënat kanë datë fillimi nga viti 2017 deri më 2023 dhe përfshijnë të gjitha projektet e realizuara në nivel bashkie. Ajo shpjegoi se projektet prekin sektorë të ndryshëm në fusha si ekonomia dhe turizmi, mjedisi, bujqësi, pyje etj. të grupuara sipas fushave të ngjashme.

Znj. Valbona Karakaçi, Ekspert, Helvetas ngriti pyetjen nëse këto janë fonde që kanë kaluar nga llogaria bankare e bashkisë, pasi shpesh ka shumë projekte të cilat bashkia i përfiton por ato nuk vetë-administrohen drejtpërdrejt prej saj.

Z. Elton Stafa, Team Leader, NALAS shpjegoi se në të dhëna është pasqyruar vlera e plotë e projektit, pavarësisht nëse fondet administrohen ose jo drejtpërdrejtë nga bashkia përmes sistemit të thesarit.

Znj. Karakaçi u interesua nëse është përdorur gjithashtu dhe databaza e SASPAC, ku janë të listuara të gjitha projektet e donatorëve me përfitues bashkitë, apo nëse janë përdorur të dhëna nga llogaritë bankare të bashkive në nivel thesari.

Znj. Caca shpjegoi se ka ekzistuar një databazë dhe një raport për Integrimin Evropian të bashkive, dhe se kjo databazë është përdorur si burim për raportin e performancës.

Znj. Shapo vijoi duke theksuar se në raport duhet të përfshihen të gjitha bashkitë (61 bashki) me projekte, pasi marrim shembull programi “Bashki të Forta” ka asistuar të gjitha bashkitë, si në sistemin e performancës ashtu dhe në fusha të tjera. Ajo theksoi se në shumë raste, projektet aplikohen dhe fitohen nga qeveria qendrore, por produkti final u shërben bashkive. Në këto raste fondet nuk kalojnë nëpërmjet thesarit të bashkive. Nëse bihet dakord për këtë tregues, duhet të theksohet në pasaportën e tij, duke konsideruar vetëm projektet që janë përgatitur dhe përfituar nga bashkitë, dhe ku fondet administrohen përmes sistemit të thesarit të bashkisë. Vetëm në këtë mënyrë mundësohet një krahasim real dhe i drejtë midis bashkive.

Z. Elton Qendro, Këshilltar, OSCE ngriti pyetjen lidhur me 8 bashkitë të cilat nuk kanë përfituar projekte. Ai u shpreh se këto bashki nuk janë fituese pasi nuk kanë aplikuar nëpër projekte apo kanë arsye të tjera.

Z. Erton Kashta, Project Officer, Bashki të Forta kërkoi sqarime mbi tipologjinë e projekteve të referuara në databazë. Ai kërkoi të kuptonte si është përdorur kjo databazë për gjenerimin e të dhënave, duke theksuar se mungesa e një pasaporte treguesi dhe formulimi i pyetjes drejtuar bashkive mund të kenë ndikuar në mënyrën e kuptimit dhe në saktësinë e të dhënave. Duhet të qartësohet koncepti i projekteve që do të numërohen, përkufizimin e fondit në tërësi, si edhe dallimin midis projekteve ku fondet menaxhohen drejtpërdrejt nga bashkia dhe atyre ku bashkia është përfituese apo partnere. Në përfundim, ai sugjeroi që në këtë ushtrim të përfshihet një pyetje e qartë dhe e strukturuar e cila përfshin: llojin e projektit, kuptimin e fondit dhe mënyrën e ndarjes apo menaxhimit të tij.

Znj. Aulona Hazbiu, Ekspert, Bashki të Forta dha sugjerimin që, duke konsideruar relevancën e kapitullit 22 dhe nevojën për krijimin e treguesve që lidhen më të, të fokusohet vëmendja te aftësia e bashkive për të **përthithur fonde nga Bashkimi Evropian**. Ajo theksoi se AMVV është duke punuar për forcimin e kapaciteteve absorbuese të bashkive. Sipas saj, edhe pse ka fonde të ofruara nga shtete të ndryshme, më relevante mbeten fondet e përthithura nga BE.

Z. Kashta vijoi duke theksuar rëndësinë e forcimit të kapaciteteve, shtoi se fokusi duhet të jetë edhe tek numri i punonjësve që merren konkretisht me fushën e projekteve në bashki, pasi numri i projekteve të përfituara është i lidhur drejtpërdrejt me kapacitetet njerëzore të bashkisë.

Znj. Hazbiu sqaroi më tej se tashmë është duke u ndërmarrë një hap drejt krijimit të strukturave ose njësive të integritit në bashki dhe se aktualisht ky proces ndodhet në fazën e miratimit së bashku me VKM 450 e cila ridimensionon kompetencat e zyrave të integritit.

Znj. Shapo theksoi se për ushtrimin e SMP-së për vitin 2024, ndryshe nga viti i kaluar, duhet të përfshihen dy tregues:

1. **Numri i projekteve të bashkëpunimit ndërbashkiak** (duke e cilësuar si hapin e parë të kapitullit 22) dhe dokumenti verifikues do të jetë marrëveshja e firmosur;
2. **Numri i projekteve të përfituara**, pa u fokusuar te vlera e fondit, pasi numri i projekteve reflekton më saktë angazhimin dhe kapacitetin e bashkisë sesa vlera financiare e përfituar.

Znj. Klarina Allushi, Project Coordinator, IOM sugjeroi që është e nevojshme përfshirja e një treguesi që i përket **fushës së migracionit dhe diasporës**, pasi bashkitë kanë kompetencë për ngritjen e strukturave të dedikuara për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në këtë fushë. Ajo theksoi se, nisur nga neni 29/1 i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ku migracioni dhe diaspora përcaktohet si kompetencë e bashkive, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë në rritje që ky funksion ka marrë në politikat e qeverisë, vlerësohet e domosdoshme përfshirja e një treguesi që mat nivelin e bashkëpunimit ndërbashkiak. Konkretisht, ajo propozoi që të matet numri i **marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga bashkitë** në të gjithë vendin. Sipas saj, ky aspekt është i rëndësishëm jo vetëm në kontekstin e funksionit të diasporës dhe migracionit, por edhe në kuadër të integritit të vendit në Bashkimin Evropian, pasi bashkëpunimi ndërbashkiak shërben si një mjet që nxit zhvillimin ekonomik dhe social të territorit. Në këtë kuadër, znj. Allushi propozoi përfshirjen e këtyre treguesve:

1. **Plane për diasporën dhe migracionin të miratuara;**

Z. Stafa, theksoi se numri total i projekteve të përgatitura dhe aplikuara nga bashkitë është një tregues i rëndësishëm që reflekton përpjekjet e tyre për të thithur fonde dhe përmirësimin e vazhdueshëm në këtë drejtim. Ai shtoi se, megjithëse bashkitë e mëdha mund të kenë mundësi dhe kapacitete më të mëdha për të përfituar projekte, kjo nuk duhet të dekurajojë bashkitë e vogla apo të mesme. Sipas tij, është e rëndësishme që edhe këto bashki të marrin pjesë në aplikime për projekte, pavarësisht nëse për zgjidhen fituese apo jo.

Ai propozoi që si tregues i vlefshëm mund të konsiderohet:

- **Numri i projekteve të përgatitura dhe aplikuara nga bashkia, qoftë në partneritet apo individualisht.**

Gjithashtu, ai vuri në dukje se numri i thirrjeve për aplikime ndryshon nga viti në vit, pasi ka periudha kur thirrjet janë më të shumta dhe periudha të tjera kur ato mund të mungojnë apo të vonohen, duke ndikuar kështu edhe në mundësinë e aplikimit nga bashkitë.

Znj. Shapo ngriti pyetjen lidhur me grupin e donatorëve të cilët do të merren në shqyrtim në analizë, nëse do të merren në konsideratë vetëm projektet e BE-së apo të gjitha projektet e financuara nga donatorë të ndryshëm. Ajo u shpreh se ishte në favor që të merren të gjithë donatorët.

Z. Qendro u shpreh se e sheh shumë të **vlefshëm treguesin e aplikimit në projekte, së bashku me treguesin e fitimit të këtyre projekteve për të cilat është aplikuar.**

Znj. Caca vijoi duke shpjeguar se projektet e përfshira në këtë analizë janë projektet “stock” të realizuara në periudhën 2017-2024. Ajo theksoi se, nëse ky tregues do të ruhet i pandryshuar edhe për vitin e ardhshëm dhe për të mundësuar një krahasim të drejtë me raportet e mëparshme të SMP-së, treguesit duhet t’i shtohet vetëm viti i fundit. Sipas saj, nëse në analizë do të merret vetëm një vit kalendarik, ky tregues nuk do të ishte gjithëpërfshirës, pasi projektet kanë një kohëzgjatje që shpesh shkon përtej një viti.

Z. Stafa vazhdoi duke theksuar se ky tregues mund të bëhet më universal duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e një projekti. Ai sugjeroi disa pyetje që mund të zhvillohen për këtë tregues, si: “A zbatohet projekti në kohë?”.

Znj. Caca u shpreh se ky është një tregues që nuk mund të monitorohet ende, pasi për të marrë përgjigjen e pyetjes së ngritur, duhet të presim përfundimin e projektit dhe duhet të monitorojmë në mënyrë të vazhdueshme bashkitë.

Znj. Karakaçi theksoi cilësitë e një treguesi të mirë, të cilat lidhen me thjeshtësinë dhe krahasueshmërinë.

Z. Stafa vijoi duke shpjeguar se nëse përfshihet një periudhë dy vjeçare, mund të merren të dhëna më të thjeshta dhe të plota. Ai sugjeroi që propozimi i treguesit mund të jetë: **Propozime të hartuara kundrejt kontrata të fituara**. Në këtë mënyrë e dhëna merret sintetike.

Znj. Shapo shtoi se duhet parë më gjerësisht përfitimi dhe menaxhimi i projekteve. Ajo theksoi se, nëse një bashki fiton katër projekte brenda një viti dhe për shkak të kapaciteteve të kufizuara, vitin pasardhës nuk aplikon në asnjë projekt pasi është e angazhuar me menaxhimin e projekteve të fituara, kjo nuk do të thotë se ka performancë më të dobët se bashkitë e tjera.

Znj. Allushi replikoi duke theksuar se më shumë rëndësi ka monitorimi dhe vlerësimi i normës së suksesit të aplikimeve për projekte.

Znj. Caca shpjegoi se të dhënat përdorin konceptet “flow” dhe “stock”. Në rastin konkret, për disa tregues që lidhen me donatorët, fondet ose numrin e projekteve të përfituara, ka kuptim që të konsiderohen si të dhëna “stock”, pavarësisht statusit të projektit. Ndërsa, nëse synohet të kuptohet dinamika vjetore, pra ngjarjet e ndodhura brenda 1 viti duhet të merren në analizë aplikimet dhe projektet e fituara brenda vitit konkret, që përfaqësojnë të dhëna “flow”.

Z. Stafa shpjegoi se, për matjen e performancës së bashkive në fushën e projekteve është e rëndësishme të përcaktohen qartë dimensionet që duhen vlerësuar. Ai theksoi se një ndër elementët që tregon performancën është kapaciteti institucional, si dhe realizimi i buxhetit të projekteve. Fondet e shpenzuara janë lehtësisht të verifikueshme, duke qenë se bashkitë janë të detyruara të raportojnë pranë Ministrisë së Financave çdo shpenzim që lidhet me projektet. Ai përmendi se sipas një udhëzimi të nxjerrë në korrik 2024, metoda primare e zbatimit të projekteve do të jetë përmes llogarive të thesarit, duke shmangur nevojën për hapjen e llogarive të tjera.

Znj. Caca përmbylli takimin duke u shprehur se konsultimet dhe propozimet e ndara gjatë takimit, do t'u shpërndahen gjithë pjesëmarrësve.

Përfundime

Në përfundim të takimit, u dakortësuan treguesit e mëposhtëm:

- 1. Projekte të fituara kundrejt të aplikuara nga Bashkimi Evropian;**
- 2. Plane për diasporën dhe migracionin të miratuara nga bashkitë;**
- 3. Numri i marrëveshjeve ndërbashkiake të nënshkruara nga secila bashki.**

Gjithashtu, anëtarët e grupit të punës ranë dakord që indikatorët të shqyrtohen sërish, me qëllim hartimin e një liste të qartë treguesish, nga ku do të bëhet përzgjedhja e treguesive përfundimtare që do të përdoren për matjen e performancës.